



## Permbledhje joteknike e aktiviteve

*“Rritje intensive e gjedhit ne nje instalim”*



**Subjekti:** “Flori” sh.p.k.

**Hartoi:** “EKO- STUDIO-PROJEKT” sh.p.k

**Administrator:** Shkelzen MABANI



Tirane, 2022



## **PERMBAJTJA**

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobeseve ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisit tetipave A,Bdhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



## **1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

Zona prej te cilave eshte marre ne studim ndodhet ne Njesine Administrative Balldren i Ri, Bashkia Lezhe.

Aktiviteti : Kompleks gjedhesh (mbareshtim lopesh) zhvillohet Afer Hidrovorit, Balldrem i Ri ne qytetin e Lezhes.

Ky aktivitet ka ferme me 444 krere lope te races brown (austriake) te cilat perdoren me se shumti per qumesht me nje rendiment prodhimi mesatarisht 20.2 kg.

Lenda e pare qe perdoret per ushqimin e lopeve eshte jonxha e thate me nje sasi prej 3kg ne dite e cila sjell rendimentet me te larta te prodhimit dhe prodhohet vete nga punetoret.

Pervec lendes se pare, nuk mungojne as lendet ndihmese sic jane : silazhi barit te thate me nje sasi prej 10 kg, silazhi i misrit i perbere nga (miser, bersi soje, hime dhe elb) me nje sasi prej 15 kg ne dite dhe koncentrate 6.5 kg te cilat merren te gatshme.

Sasia vjetore e ushqimit qe prodhohet ne vit eshte :

24000 kv silazh misri ;

3000 kv jonxh i thate.

Ushqimi perpunohet e transportohet me makineri dhe ruhet ne magazina te medha prane stallave.

Furnizimi me uje te gjedhit (lopeve) sigurohet me ujesjelles, por ne rast te mungeses se ujit perdoret dhe shpimi.

### **Punimet E Ndertimit**

Ferma eshte e perbere nga 6 stalla te medha, nga ku secila stalle ka nje siperfaqe te bollshme prej 500 m<sup>2</sup>, me kushte shume te mira sic eshte ajrimi dhe ndricimi i tyre.

Dezinfektimi i stallava behet me gelqere dhe kryhet ne menyre te shpeshte nga puntoret

Pervec stallave aty prane ndodhen ndertesa e perbere nga dy zyra, dy tualete, dhoma e zhveshjeve per punetoret, dhoma qe lihet makinerite per prodhimin e qumshtit.



## **2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

### **Trashegimia kulturore**

Nga konstatimi ne zone, territori ne studim nuk ndodhet ne distanca te aferta me zonat e mbrojtura nga Instituti i Monumenteve te Kultures . Ne zonen ku ndodhet veprimtaria nuk ka objekte arkitektonike, arkeologjike, kulturore dhe me interesa historike.

### **Relievi**

Relievi i rajonit është i ndryshëm në pjesën perëndimore është fushor me kuotë të ulët mbi nivelin e detit dhe në pjesën lindore është kodrinor – malor në të gjithë zonën e fshatrave të malësisë në një kuotë deri në 700 metra mbi nivelin e detit.

### **Klima**

Në territorin e rajonit mbizotëron klima mesdhetare, ka fusha pjellore, ka kodrina të ulëta, ka vargmale me lartësi mbi 700 m mbi nivelin e detit, ka pyje të dendur. Klima mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë e dimër të butë e të freskët, është tipike për zonën fushore e kodrinore. Karakteristike për çdo stinë të vitit janë erërat e forta që fryjnë nga verilindja dhe lindja e drejtohen nga korridoret natyrore, shpatet e maleve. Nga pikëpamja e temperaturave vërehen amplituda të mëdha midis dimrit dhe verës. Temperatura mesatare vjetore është 15,6 gradë celcius, kurse amplituda mesatare është 18 gradë celcius. Reshjet në territorin e rajonit kanë një shpërndarje të pabarabartë. Sasia mesatare e reshjeve është 1350mm në vit. Në zonën malore, kryesisht aty ku bie dëborë në dimër, reshjet janë të pranishme edhe gjatë verës, kurse në zonën kodrinore dhe fushore vera është e thatë. Ditët me diell variojnë nga 220-240 dite, ku mesatarisht gjatë vitit ka deri 3000 orë diell.

### **Flora dhe Fauna**

Bimësia është e shpërndarë sipas kushteve klimatike, duke formuar zona bimësie si zona e shkurreve mesdhetare (zhvillohen shkurret, kryesisht shqopa e mareja), e dushqeve (lisi, gështenja), e ahishteve (ahu) dhe e halorëve (pisha). Duke u nisur sipas vetive të përdorimit në zonë rriten edhe bimët mjeksore e aromatike që përmbajnë lëndë aktive dhe esenca. Bimët mjekësore që rriten në këtë zonë janë: sherbela, trumza, kamomili, lulebliri, çaj mali, luleshtrydha, lulëkuqja, mullaga. Në zonën tonë rriten edhe bimët spontane foragjere me vlera ushqimore për bagëtinë. Në bimësinë e livadheve dhe kullotave mbizotërojmë graminoret dhe bishtajoret në gjendje të egër si: tërfili, grami, talla, shpatorja. Bimët endemike janë bimë që rriten vetvetiu brenda një territori të caktuar të kufizuar dhe rriten në vartësi të relievit e klimës. Fauna është zhvilluar në varësi të mjedisit. Kështu dallohen fauna tokësore, fauna e ujrave të ëmbla dhe fauna e egër. Shpendë të gjuetisë janë rosa e pata e egër, thëllënxa, karabullakët, çapkat etj. Kafshë të egra që rriten në këtë zonë janë dhelpra, lepuri, ujku, ariu dhe derri i egër.

### **Gjeologjia dhe dherat**



Formësimi gjeologjik i përket periudhës së rrudhosjes alpine këtu e 225-milion vjet më parë. Në këtë strukturë gjeologjike ka shkëmbenj të shumtë sedimentarë, magmatike dhe metamorfikë me rezerva të pasura xeherorësh, bakri, kromi, silici, kuarci, kaoline, gurë dekorativ e gëlqerorë, argjila, inerte etj. Me një traditë të hershme në përpunimin e tyre, të mjaftueshme për ngritjen e shumë aktiviteteve industrialo-ekonomike.

### **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

#### **Shkarkime në ujë**

Gjate fazes së funksionimit ujerat që do të përdoren do të jenë kryesisht për larje dhe do të grumbullohen dhe menaxhohen në gropa dekantimi. Aty do të bëhet trajtimi i ujerave, ndarja e sedimenteve dhe llumrave nga ujerat dhe më pas bëhet derdhja në kanalizime.

#### **Emetimet në ajër**

Emetime në ajër gjate fazes së funksionimit nuk do të ketë. Ajo çfarë do të vihet re do të jetë era e pakëndshme në stallat e gjedheve. Ky ndikim është i përhershëm për sa kohë është aktiviteti në funksionim.

#### **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurmat që gjenerohen nga aktiviteti janë zhurmat që vijnë nga gjedhet të cilat janë brenda norma të lejuara. Gjithashtu këto emetime nuk përbejnë bezdi të banorëve të zonës pasi janë larg qendrave të banuara.

#### **Ndikimi në tokë**

Gjate fazes së funksionimit nuk do të ketë ndikime në tokë për shkak të vetë llojit të aktivitetit.

#### **Ndikimi në biodiversitet**

Për shkak të natyrës së aktivitetit, në mjediset e stallave do të kemi shtim të insekteve dhe gjallesave të tjera të cilat ushqehen me mbetjet e gjedheve. Ky do të jetë një ndikim i cili do të zgjase për sa kohë zhvillohet aktiviteti. Ndikime në flore nuk do të ketë.

### **4. MASAT PËR ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**



Ujrat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitorimi periodik i ujerave qe do te shkarkohen ne kanalizime.</li> <li>• Mirembajtja e vaskave dekantuese per nje trajtim eficient.</li> <li>• Pastrimi i mjedisit ne rast te shkarkimeve aksidentale ne Kanalin e Muratit</li> </ul>
Ajri	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sperkatja me uje e sheshit gjate periudhes se ndertimit.</li> <li>• Pastrimi periodik i mjedisit dhe stallave te gjedheve per largimin e aromes se pakendshme.</li> <li>• Shtim i bimesise perreth zones se aktivitetit.</li> </ul>
Toke	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Te behet betonizimi i stallave per te mos patur rrjedhje aksidentale ne toke.</li> </ul>
Zhurma dhe vibrime	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Te fiken automjetet e punes gjate fazes se ndertimit</li> <li>• Te kryhet monitorimi periodik i zhurmave dhe vibrimeve.</li> </ul>
Mbetjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbetjet e ngurta urbane qe do te prodhohen ne objekt te depozitohen ne vendet e percaktuara nga NJ.Q.V, madje jane vendosur koshat qe keto mbetje ti ndaje sipas karakterit te tyre.</li> </ul>

### **Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune**

#### ***Detyrimet e punedhenesit***

Per te shmangur aksidentet ne pune, punedhenesi vetë i ka bërë të ditur punëmarrësve:

- Proçesin teknologjik në tërësi dhe specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet dhe makineritë që janë në përdorim.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës në instalimin ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajtur shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

#### ***Detyrimet e punëmarrësit:***

- Të njoh mirë proçesin e punës dhe makinerite apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfare masash duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë.



- Të ketë njohuri të mjaftueshme per ndihmën e shpejtë.
- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.